

C. nr. 222/2007

GJYKATA: GJYKATA THEMELORE E PEJËS
DEGA E KLINËS

GJYQTARI: Gjyqtari i EULEX-it Manuel Soares

PADITËSI: RB nga Peja, i përfaqësuar nga avokati HH nga Prishtina

TË PADITURIT: AK dhe RK nga Peja, fshati Zahaq, të përfaqësuar nga avokatët ZM dhe CG, nga Klina

LËNDA: Rikthimi i pasurisë dhe kompensimi i dëmit

SEANCA KRYESORE Përfunduar më 16 mars 2009
Caktuar Gjykatësit të EULEX-it më 21 qershor 2013

DATA E AKTGJYKIMIT: 24 tetor 2013

I. DISPOZITIVI

1. Pranohet kërkesa e paditësit që të paditurit t'i dorëzojnë atij lokalet afariste që ata po mbajnë në posedim të tyre në pronën e tij të paluajtshme në ngastrën kadastrale (...) të listës poseduese (...), Komuna Kadastrale e Klinës;
2. Refuzohet si e pabazë kërkesa e paditësit që të paditurit t'i paguajnë atij kompensimin në shumën totale prej €175,795, përfshirë interesat ligjore;
3. Refuzohet si e pabazë kundërpadia e të paditurit të parë, me të cilën kërkon vërtetimin e pronësisë së tij mbi lokalet në katin përdhes me një sipërfaqe prej 114,63 m² në pjesën jugore të lokaleve afariste në pronën e përmendur, dhe konfirmimin e bashkë-pronësisë së tij mbi pjesët e tjera të së njëjtës ndërtesë në bodrum dhe në katin përdhes;
4. Pranohet pjesërisht kundërpadia e të paditurit të parë, e cila kërkon që paditësi të detyrohet t'i paguajë kompensimin në shumën €3.741,78 për investimet e bëra në atë pronë, dhe për këtë arsye paditësi urdhërohet t'i paguajë të paditurit të parë shumën prej €44.230,67 (dyzet e katër mijë e dyqind e tridhjetë euro dhe gjashtëdhjetë e shtatë cent).
5. Secila palë do të paguajë shpenzimet e veta të procedurës.

II. ARSYETIM

Komente hyrëse: të gjitha dispozitat ligjore të cekura në këtë aktgjykim do të jenë në lidhje me ligjet e mëposhtme, që do të citohen me shkurtesa:

- Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (“LPK”);
- Ligji Nr. 29/70 mbi Kontratat dhe Detyrimet, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligjet 39/85, 45/89, 57/89 dhe 31/91, të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Federative të Jugosllavisë (“LKD”);
- Ligji mbi Marrëdhëniet Pasurore Themelore, botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr. 6/80 (“LMPH”);
- Ligji për Tregtinë e Pronës së Patundshme, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Serbisë, Nr. 43/81 (“LTPP”);
- Ligji Nr. 03/L-154 për Pronën dhe të Drejtat e Tjera Reale (“LPDR”).

II.1 ÇËSHTJE PROCEDURALE

Sipas nenit 512.1 të LPK-së, të zbatueshme për këtë lëndë janë procedurat e Ligjit aktualisht në fuqi, pasi gjykata tashmë e ka kryer veprimin procedural të paraparë në paragrafin 2 të të njëjtit neni në seancën që u zhvillua më 30/1/2009 (faqe 195).

Kjo lëndë filloi me një kërkesë për rindërtimin e një padie të ngritur më 8/9/1997 nën C. nr. 230/97 (faqja 11). Veprimi procedural i vetëm i njohur i asaj lënde të “zhdukur” është kopja e aktvendimit të datës 5/2/1998 që e pezullonte procedurën për 6 muaj. Arsyet për këtë vendim nuk janë të njohura, por është e rëndësishme të vlerësohet konteksti i konfliktit të vazhdueshëm që ndikonte në atë kohë funksionimin e rregullt të institucioneve publike, siç ishin gjykatat. Përfaqësuesi i paditësit i kërkoi kryetarit të gjykatës të gjente shkresat e lëndës (faqja 9), por nuk ka dijeni për asnjë përgjigje ndaj kësaj kërkesë, me siguri për shkak se shkresat e lëndës nuk u gjetën në arkivin e gjykatës. Në vend të kësaj, kopja e përmendur e aktvendimit u dorëzua gjatë një seance dëgjimore nga njëri prej avokatëve që e kishte atë në posedim të tij për arsye të panjohura. Përveç asaj kopjeje, nuk ka prova shkresore për ekzistencën e C.nr. 230/97 të “zhdukur”, apo të ndonjë veprimi procedural të kryer para dhe pas atij vendimi. Në këtë fazë është e qartë se rindërtimi i lëndës së supozuar të “zhdukur”, sipas rregullave të nenit 32 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave të Kosovës, të miratuara nga KGJK më 4/1/2012, thjesht nuk është i mundur. Dhe, për më tepër, padia procedoi për të gjitha këto vite si shkresa të një lënde të re duke shpërfillur çdo rindërtim të mundshëm të shkresave të lëndës së supozuar të “zhdukur” dhe në lidhje me rregullat procedurale të zbatueshme dhe të

drejtat e palëve. Pra, meqenëse është bërë deri më tani, gjykata do ta japë këtë aktgjykim duke shpërfillur kërkesën fillestare për rindërtimin e një lënde të vjetër të zhdukur.

Në seancën e datës 31/5/2005 (faqja 102), paditësi ngriti disa dyshime procedurale lidhur me pranimin e kundërpadisë. Por ai nuk është i saktë, sepse me aktvendim të marrë në seancën e datës 6/1/2005 (faqe 88), kundërpadia u pranua dhe i padituri u ftua të përgjigjej.

Prandaj nuk ka asnjë pengesë procedurale që gjykata të shqiptojë aktgjykimin përfundimtar lidhur me meritat e konfliktit.

II.2 PRETENDIMET E PALËVE

Paditësi kërkoi që të paditurit (1) t'i dorëzojnë atij lokalet afariste që ata po mbajnë në posedim të tyre në objektin në pronën e tij të paluajshme në ngastrën kadastrale (...) të listës poseduese (...), Komuna Kadastrale e Klinës, dhe (2) që ata t'i paguajnë atij një kompensim që përputhet me vlerën e qirave që ai do të kishte marrë nëse lokalet afariste nuk do të ishin zënë nga të paditurit, në shumën totale prej €175,795, përfshirë kamatat ligjore.

Të paditurit u përgjigjën duke deklaruar se paditësi i parë është pronar i 120m² të objektit që iu dha atij nga paditësi si kompensim për punën e tij në bartjen e të drejtave pronësore tek ai dhe për sigurimin e autorizimit për ndërtimin, dhe se ai shpenzoi €34,000,00 për ndërtimin, që paditësi do të duhet t'ia paguajë atij.

I padituri i parë, AK, paraqiti kundërpadi duke kërkuar që (1) të vërtetohet se ai është pronari i lokaleve në katin përdhes, me sipërfaqe 114,63 m², në pjesën jugore të lokaleve afariste në objektin e ndërtuar mbi pronën e përmendur të regjistruar në emër të paditësit, (2) gjithashtu të konfirmohet se bashkë me paditësin ai është bashkë-pronar i pjesëve të tjera të ndërtesës së njëjtë në bodrum dhe katin përdhes (2) që ai të detyrohet t'ia paguajë atij dëmshpërblim në shumën €3.741,78 për investimet e bëra në pronë.

II.3 FAKTET E PARAQITURA DHE PROVAT E EKZAMINUARA

II.3.1 Faktet përkatëse (treguesit përmbledhës)

Faktet e paraqitura nga paditësi (parashtrësat: faqet 1 dhe 27):

- Paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr. (...);
- Paditësi u autorizua nga autoritetet komunale për të ndërtuar një objekt që do të përfshinte lokale afariste në katin përdhes;

Paditësi bleu të gjitha materialet dhe pagoi për të gjitha punimet që lidheshin me ndërtimin;

- I padituri i parë mbikëqyri ndërtimin gjatë mungesës së tij;

- Pas ndërtimit të bodrumit dhe katit përdhes, i paditur i parë, pa autorizimin e paditësit, hyri në posedim të lokaleve afariste dhe i përdori ato, si dhe i padituri i dytë, deri në momentin aktual;
- I padituri i parë i dha me qira lokalet afariste dhe mori shumën €6.950,00 nga qiratë nga viti 1993 deri në vitin 1996 dhe €3.600,00 nga qiratë në vitin 1997;

Faktet e paraqitura nga të paditurit në përgjigjen ndaj padisë (parashtrësas: faqe 171 dhe 197):

- Paditësi dhe i padituri i parë ishin pajtuar që paditësi t'i japë të paditurit të parë një lokal afarist në katin përdhes të ndërtesës, me sipërfaqe 120m², si kompensim për punën e tij për bartjen e pronësisë dhe marrjen e lejes së ndërtimit;
- Bartja e së drejtës pasurore tek paditësi dhe marrja e lejes së ndërtimit nga komuna ka qenë një proces i gjatë, i vështirë dhe i kushtueshëm dhe është kryer nga i padituri i parë;
- Paditësi dhe i padituri i parë u pajtuan që i padituri i parë ta përfundojë ndërtimin e objektit duke investuar paratë e tij;
- Paditësi investoi €25.000,00 për blerjen e pronës dhe €6.000,00 për ndërtimin;
- I padituri i parë shpenzoi shumën totale prej €34.000,00 për ndërtimin;

Nga i padituri i parë lidhur me kundërpadinë (parashtrësë: faqe 176):

- Shuma totale e shpenzuar për ndërtimin e objektit ishte €70.311,48;
- Paditësi investoi €16.569,70 dhe i padituri i parë investoi €3.741,78;

II.3.2 Provat e ekzaminuara

- Proces-verbali me propozim-marrëveshjen e dhënë nga paditësi të paditurit të parë, datë 14 korrik 2002 (faqja 8);
- Kontrata e datës 23/12/1987, nr. 711/1987 (faqja 87);
- Dëgjimi i palëve (faqet 45, 50 dhe 60);
- Dëgjimi i dëshmitarëve PB, HK, ShZ, DSh, TK, HH dhe BB (faqe 76);
- Këqyrja e vendit (faqe 40);
- Ekspertiza lidhur me çmimin e ndërtimit (faqe 43 /2);
- Raportet e ekspertizës mbi rivlerësimin dhe konvertimin e shumave në monedhën euro (faqet 67 dhe 138).

Nuk u paraqitën dokumente të tjera nga paditësi. Dëshmitari EH nuk u dëgjua asnjëherë për shkak se në parashtrësën e datës 14/7/2003, paditësi e tërhoqi propozimin për dëgjimin e këtij dëshmitari (faqja 27, pika 4).

II.4 VËRTETIMI I GJENDJES FAKTIKE

Vërtetimi i gjendjes faktike do të trajtojë vetëm faktet e paraqitura nga palët në padinë e tyre, përgjigjen ndaj padisë dhe kundërpadisë, sipas neneve 7.1, 253.1b), 319.1 dhe 396.2 të LPK-së. Çdo fakt tjetër i deklaruar në seancat gjyqësore të palëve ose nga ndonjë dëshmitar nuk do të merret parasysh për shkak se objekti faktik i lëndës mund të pretendohet vetëm në padi apo përgjigjen ndaj padisë, ose në një parashtrësë të veçantë për të plotësuar ose modifikuar padinë që nuk u ngrit kurrë.

II.4.1 Faktet e provuara

Bazuar në provat e ekzaminuara që u përshkruan më lart, dhe duke pasur parasysh rregullat mbi barrën e provës, Gjykata gjen se faktet në vijim u provuan:

- a) Me kontratën me shkrim, të vërtetuar në gjykatë më 23/12/1987, paditësi i përfaqësuar nga i padituri i parë, bleu ngastrën kadastrale nr. (...), Lista Poseduese nr. (...), Komuna Kadastrale e Klinës, me sipërfaqe 0.05.98 ha, dhe pagoi për të çmimin prej 1.150.000 dinarësh;
- b) Pas kontratës, paditësi bleu materiale dhe pagoi punëtorë për fazën fillestare të ndërtimit, madje para se të merrte autorizim nga autoritetet komunale, duke shpenzuar shumën prej €6.000,00;
- c) Në vitet 1984-1985, paditësi dhe i padituri i parë bënë marrëveshje gojore se i padituri do t'i jepte të paditurit të parë një lokal afarist në katin përdhes të objektit të ardhshëm që do të ndërtohej, me sipërfaqe rreth 120 m², si kompensim për punën e tij për bartjen e pronësisë dhe marrjen e lejes së ndërtimit;
- d) Bartja e së drejtës së pronësisë tek paditësi nga viti 1984-85 deri në vitin 1987, dhe marrja e autorizimit komunal për ndërtimin gjatë rreth një viti pas lidhjes së kontratës, qe një proces i gjatë, i vështirë dhe i kushtueshëm dhe u krye nga i padituri i parë;
- e) Më në fund paditësi u autorizua në vitin 1988-1989 nga komuna për të ndërtuar një objekt që do të përfshinte lokale afariste në katin përdhes;
- f) Paditësi dhe i padituri i parë u pajtuan që i padituri i parë të përfundonte ndërtimin e objektit duke e mbikëqyrur atë dhe duke investuar paratë e tij;
- g) Vlera totale e ndërtimit të objektit, me çmime aktuale, është €70.311,48;
- h) Për ndërtimin paditësi investoi shumën e përgjithshme €16.569,70, përfshirë shumën fillestare të përmendur më lart në paragrafin b), dhe i padituri i parë investoi €28.105,37 në total;
- i) Pas ndërtimit të bodrumit dhe katit përdhes, rreth viteve 1989-1990, i padituri i parë hyri në posedim të një pjese të objektit në katin përdhes, me sipërfaqe totale 114,05 m², e ndarë në dhomat A, B, B1 dhe C (të shënuara me të kuqe në planet në faqen 43/11), me sipërfaqet përkatëse 48,58 m², 50.274 m², 2.796 m² dhe 13,48 m², të cilat në këtë moment janë të okupuara nga i padituri i parë dhe gjithashtu nga i padituri dytë sipas autorizimit të të paditurit të parë;

j) I padituri i parë i dha me qira ato lokale afariste që ai ishte duke i shfrytëzuar, duke i konsideruar si pronë e tij, dhe mori 700DM pagesë për shtatë muaj qira në vitin 1993 nga JGj dhe 1050DM për shtatë muaj me qira pas vitit 1993 nga HK; nga 1 korriku 1996, i padituri i parë i dha me qira edhe EH një pjesë të lokale afariste që ai nuk ishte duke i shfrytëzuar, për shkak se i konsideronte si pronë të paditësit, por deri më 31 dhjetor 1996 nuk u pagua qira, sepse u vendos të kompensohej investimi në shumën 12,000 deri në 13.000 DM, i bërë nga EH për lokalet.

II.4.2 Faktet që nuk u provuan

Bazuar në provat e ekzaminuara që do të përshkruhen më poshtë, gjykata konsideron se faktet e mëposhtme të pretenduara nuk u provuan:

- a) Të gjitha materialet dhe të gjitha punimet për ndërtimin u paguan nga paditësi;
- b) Shumat e qirave të marra nga i padituri i parë ishin €950,00 nga viti 1993 deri në vitin 1996 dhe në vitin 1997 €600,00;
- c) I padituri i parë hyri në posedim të një pjese të lokaleve afariste pa autorizimin e paditësit;
- d) Shuma prej €70.311,48 është kostoja totale e shpenzuar nga palët për ndërtimin;
- d) Paditësi investoi vetëm €6.000,00 për ndërtimin;
- f) I padituri i parë investoi €3.741,48 për ndërtimin.

II.4.3 Arsyetimi për faktet e provuara dhe të pa provuara

Për faktet e provuara në II.4.1:

- a) kontrata e ekzaminuar e datës 23/12/1987 nr. 711/1987, në faqen 87 të shkresave të lëndës, e cila nuk është kontestuar nga palët, është provë e mjaftueshme për blerjen dhe çmimin përkatës. Paditësi tha se çmimi ishte 21,700 dollarë amerikanë (seanca dëgjimore, faqe 45) dhe i padituri i parë tha se ishte €25.000,00 (përgjigjja në padi në faqet 171 dhe 197), por meqenëse nuk ekziston asnjë provë e shndërrimit të vlerës së dinarëve në vitin 1987 në dollarë amerikanë ose në euro, gjykata konsideron si më të saktë çmimin e përmendur në kontratën me shkrim. Megjithatë, si në parashtresat, ashtu dhe në dëgjimet e tyre, të gjitha palët ranë dakord se çmimi u pagua nga paditësi. Dhe kjo është ajo që ka rëndësi për këtë qëllim.
- b) Fakti që paditësi bleu materiale dhe pagoi punëtorët në shpenzimet në fazën fillestare, duke shpenzuar €6.000,00 u pranuan nga të paditurit në përgjigjen në padi (faqet 171 dhe 197). Paditësi pretendoi se ai i pagoi të gjitha materialet dhe të gjithë punëtorët, por ai nuk dha prova për ta mbështetur këtë pretendim. Prandaj, gjykata konsideroi si të provuar vetëm faktin që u pranua nga të paditurit.

c) Marrëveshja lidhur me përdorimin e një dyqani në objekt nga i padituri i parë u kontestua nga palët. Padiësi argumentoi se ai ra dakord t'i jepte me qira një dyqan të paditurit të parë, por të paditurit pretendojnë se ai premtoi t'ia japë atë pa pagesë. Përfundimi i sigurt është se mes padiësit dhe të paditurit të parë u arrit një lloj marrëveshjeje, sepse ata të dy i referohen asaj. Dhe është gjithashtu e sigurt se kjo marrëveshje ka të bëjë me ndërtimin e objektit, sepse edhe padiësi e pranoi këtë në fjalën e tij përfundimtare (faqet 141, 145 dhe 170). Për më tepër, është e arsyeshme dhe çështje logjike të shëndoshë të supozohet se marrëveshja duhej të ishte e leverdishme për të paditurin e parë, sepse nuk do të kishte logjikë që ai të shpenzonte të holla, kohë dhe përpjekje, të bënte sakrifica personale, vetëm që të kishte një dyqan të marrë me qira. Kjo është diçka që ai mund ta siguronte me lehtësi diku tjetër. Pikërisht në bazë të kësaj marrëveshjeje i padituri i parë hyri në posedim të sipërfaqes prej rreth 120 m² në katin përdhës. Prandaj, versioni i të paditurit të parë rreth asaj marrëveshjeje është shumë më i besueshëm se versioni i padiësit. Edhe për shkak se padiësi, duke mohuar atë që duket qartë dhe duke u përpjekur të fshehtë një fakt që është i qartë dhe i padiskutueshëm, pra, duke mos pranuar kurrë se i padituri i parë investoi paratë e tij për ndërtimin, nuk meriton aq shumë besim nga gjykata. Dhe përveç këtyre arsyeve, gjykata mori parasysh edhe dëgjimet e dëshmitarëve për ta konsideruar të provuar këtë fakt. Nuk ka asnjë arsye të fortë për të hedhur dyshime mbi vërtetësinë e dëshmive të dëshmitarëve, jo vetëm sepse ata në thelb thanë të gjithë të njëjtën gjë, por kryesisht sepse ata kanë njohje të drejtpërdrejtë të fakteve dhe janë miq me të dyja palët, pa ndonjë interes personal në rezultatin e konfliktit. Marrëveshja e provuar u arrit midis padiësit dhe të paditurit të dytë në prani të dëshmitarëve PK, HK, ShZ dhe TK, të cilët në mënyrë të qartë raportuan në gjykatë se padiësi premtoi t'ia japë të paditurit të parë një dyqan pa pagesë dhe jo t'ia jepte atij me qira.

d) Padiësi pranoi se bartja e të drejtave pasurore dhe autorizimi për ndërtimin u siguruan nga i padituri i parë. Dëshmitarët HK, ShZ, TK dhe BB, që i përcollën të gjitha këto përpjekje, konfirmuan se i padituri i parë shpenzoi shumë para dhe kohë për atë qëllim.

e) Ky fakt nuk është kontestuar nga padiësi dhe ai u confirmua nga dëshmitarët DSh, i cili punoi për ndërtimin, dhe HH, i cili bëri projektin arkitekturor të objektit.

f) Në parashtrirat e tij me shkrin, padiësi nuk e pranoi asnjëherë se i padituri i parë ka investuar paratë e tij për ndërtimin. Megjithatë, kur u dëgjua si palë (faqe 45), ai tha se nëse i padituri i parë kishte shpenzuar para për ndërtimin, kjo kishte ndodhur pa dijeninë dhe pëlqimin e tij. Ajo që padiësi nuk e shpjegoi si duhet është se si ndërtimi u ndërtua vetëm me paratë që dha ai, që qartazi nuk ishin të mjaftueshme për këtë. Dhe ai gjithashtu nuk dha asnjë shpjegim të arsyeshëm për faktin se ai i propozoi të paditurit të parë një marrëveshje me shkrim për të zgjidhur mosmarrëveshjen, duke pranuar faktin se prej tij ishin bërë investime (faqe 8). Ky qëndrim tregon se padiësi thjesht nuk dëshiron ta pranojë faktin që ai e di se nuk është në favor të tij. Por nuk ka asnjë kuptim që i padituri i parë të shpenzojë shumë para të tijat për ndërtimin e një shtëpie që nuk ishte e tija (dëshmitarët thanë se ai madje u detyrua të shiste veturën e tij dhe një lopë për të gjetur paratë për vazhdimin e ndërtimit) dhe gjithashtu

kontraktoi punëtorët dhe arkitektin (të cilët ishin dëshmitarët DSh dhe HH) në qoftë se nuk do të kishte pasur marrëveshje me pronarin dhe ai nuk fitonte asgjë. Askush nuk është aq i paarsyeshëm sa të harxhojë para dhe kohë për asnjë qëllim. Mbi këto baza, gjykata i konsideron të besueshme dëshmitë e dëshmitarëve HK, ShZ, TK dhe BB, të cilat konfirmojnë shpenzimin e parave nga i padituri parë.

g) Sipas ekspertizës (faqe 43), bazuar në ekzaminimin e ndërtesës dhe vlerën mesatare të materialeve dhe punimeve përkatëse, vlera totale e ndërtimit është €70.311,48 . Nuk ka asnjë arsye për të ngritur dyshime mbi raportin e ekspertit, për më tepër për shkak se paditësi vetëm i kundërshtoi gjetjet e ekspertit, por nuk ofroi prova më të mira në gjykatë.

h) Në kundërpadi të paditurit pranuan se paditësi shpenzoi shumën totale prej €16.569,70 (22.800 dollarë amerikanë). Paditësi pretendoi se shpenzoi më shumë, por nuk e provoi këtë. Ekspertiza (faqe 67) arriti në përfundimin se i padituri i parë shpenzoi shumën totale prej €28.105,37. Ai gjithashtu pretendoi se shpenzoi më shumë, por nuk e provoi këtë. Është e rëndësishme të theksohet se vlera e tatimit që sipas ekspertit duhet të shtohet, nuk u morparasysh nga gjykata për shkak se nuk ka prova që i padituri i parë në fakt e pagoi atë. Ajo që ka rëndësi për qëllim të përcaktimit të shpenzimeve është shuma që u pagua dhe jo shuma që sipas ligjit duhej të ishte paguar. Së fundi, kundërshtimet që paditësi paraqiti kundër përfundimeve të ekspertizës nuk janë relevante sepse eksperti ishte mjaft i kujdesshëm në vlerësimin e çdo dokumenti dhe madje shpërfilli disa që ai nuk i konsideroi të besueshme.

i) Është fakt i padiskutueshëm i pranuar nga të gjitha palët në parashtresat dhe dëgjimet e tyre se i padituri i parë hyri në posedim të një pjese të lokaleve afariste në katin përdhes pasi ai u ndërtua. Nga inspektimi në terren dhe skica në faqen 43/11 e përpiluar nga eksperti, u bë e mundur të përcaktohen saktësisht dhomat në posedim të të paditurit dhe sipërfaqet e tyre përkatëse (sipërfaqët u gjetën duke llogaritur përmasat nga muret përkatëse) – për të lehtësuar vendndodhjen e saj, gjykata vuri në dukje tregoi në skicë sipërfaqet. Të njëjtat prova tregojnë gjithashtu i padituri i dytë u autorizua nga vëllai i tij, i padituri i parë, të investonte paratë e tij në atë vend dhe pas atij investimi edhe ai hyri në posedim të këtyre lokaleve.

j) Ky fakt u pranua nga i padituri i parë në dëgjimin e tij (faqe 50 dhe 60). Ai mohoi çdo pagesë tjetër dhe paditësi nuk paraqiti asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Për faktet e pa provuara në II.4.2:

a) Sipas deklaratave të paditësit, të gjitha materialet dhe punimet u paguan nga ai. Asnjë provë nuk u paraqit për të mbështetur pretendimin e tij dhe në paragrafët a), g) dhe h) u provua se kjo nuk është e vërtetë. Gjukata nuk mundi ta vërtetojë ndarjen e saktë të shpenzimeve. E mundur ishte vetëm të konkludohet se vlera e ndërtimit është €70.311,48. Për pjesën e mbetur €25.625,41 nuk u paraqitën prova të mjaftueshme. Palët e interesuara në demonstrimin e vërtetësisë së këtij fakti kishin barrën të paraqisnin prova për ta vërtetuar këtë.

b) Paditësi nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar pretendimin e tij. E mundur ishte vetëm të konkludohej se i padituri i parë mori qiratë, gjë që ai e pranoi vetë, dhe asgjë tjetër. Ekspertiza

për vlerën e qirasë në atë zonë (faqe 138) nuk është provë e mjaftueshme se sa qira u pagua. Këtu kemi të bëjmë me realitete të ndryshme: qiraja e marrë nga i padituri i parë dhe qiraja që do të kishte qenë e mundur të merrej në qoftë se lokalet do të ishin dhënë me qira gjatë gjithë viteve dhe qiraja do të ishte paguar.

c) Siç u theksua më lart, ka pasur një marrëveshje sipas të cilës paditësi premtoi t'i jepte një dyqan të paditurit të parë dhe kjo ishte arsyeja që ai hyri në posedim të dyqanit. Për këtë arsye, nuk është e mundur të pohohet se nuk ka pasur autorizim nga ana e paditësit. Kjo nuk do të thotë se marrëveshja është apo nuk është një formë e vlefshme e bartjes së pronësisë. Kjo është një çështje që do të trajtohet më tej nga gjykata.

d) Raporti i ekspertit analizoi ndërtimin dhe e gjeti vlerën e tij bazuar në çmimet mesatare të ndërtimit dhe të materialeve. Por kjo nuk do të thotë se kaq para u shpenzuan. Kjo është arsyeja përse gjykata konsideroi të provuar vetëm vlerën e ndërtimit, por jo shpenzimet totale të bëra nga palët për këtë ndërtim.

e) Deklarata e të paditurve në përgjigjen në padi nuk u vërtetua, sepse në kundërpadi u pranua një shumë më e madhe investimi, siç u provua më lart në paragrafin h).

f) I padituri i parë kishte për detyrë të provonte pretendimin e tij se ai e shpenzoi këtë shumë. Deklarata e tij nuk është e mjaftueshme për arsye të dukshme, pasi ai është palë e interesuar. Dëshmitarët e tij vetëm dinin se ai shpenzoi para, por jo sa para. Dokumentet që ai paraqiti u morën nga eksperti dhe ai arriti në përfundimin se nuk ka prova të besueshme për një investim më të madh se €28.105,37.

II.5 ZBATIMI I LIGJIT MATERIAL

Gjykata do të fillojë t'i përgjigjet çështjes së legjitimitetit procedural të të paditurit të dytë, e ngritur në aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë që anuloi aktgjykimin e mëparshëm. Më pas, të gjitha çështjet materiale të ngritura në padi dhe kundërpadi lidhur me pronën e kontestuar dhe kompensimet për dëmet, të kërkuara nga të dyja palët, do të trajtohen në sekuencën më logjike të mundshme. Prandaj, gjykata do të trajtojë këto çështjet më tutje:

- Legjitimiteti procedural i të paditurit të dytë;
- Të drejtat pronësore mbi pronën e kontestuar: nëse i gjithë objekti i takon paditësit, apo nëse një pjesë e saj u bart tek i padituri i parë;
- Okupimi i pjesëshëm i ndërtesës nga i padituri / të paditurit: nëse ishte i autorizuar dhe legjitim, apo abuziv dhe destinacioni i pjesëve në posedim të të paditurit / të paditurve: nëse këto duhet t'i kthehen paditësit, apo duhet të mbahen nga i padituri / të paditurit;
- Kompensimi për dëmet: nëse paditësi ka të drejtë të dëmshpërblehet për privimin nga të drejtat pronësore dhe, nëse po, në çfarë shume;

- Kompensimi për dëmet: nëse i padituri i parë ka të drejtë të dëmshpërblehet për investimet e bëra për ndërtimin dhe, nëse po, në çfarë shume.

II.5.1 Legjitimiteti procedural i të paditurit të dytë

Legjitimitet pasiv do të thotë se i padituri duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë në procedurë, e cila jepet nga gjasat që pozicioni i tij ligjor të cenohet nga rezultati i kontestit. Padiësi deklaroi se i padituri i dytë është në posedim të dyqaneve të objektit, që ai kërkon t'i kthehen dhe gjithashtu kërkon shpërblim të dëmit ndaj tij. Është e qartë se padiësi i dytë duhet të konsiderohet palë legjitime në procedurë, sepse ai ka interes ligjor në kundërshtimin e padisë – siç bëri. Një çështje tjetër është të dihet nëse deklaratat e padiësit janë të drejta, d.m.th. nëse ai i provoi faktet kundër të pandehurit të dytë dhe nëse zbatimi i ligjit për këto fakte mund ta miratojë padinë kundër tij. Kjo është çështje e së drejtës materiale dhe jo e legjitimitetit procedural. Prandaj gjykata konkludon se i padituri i dytë ka legjitimitet pasiv.

II.5.2 Të drejtat pasurore

U provua se rreth viteve 1984-1985, padiësi dhe i padituri i parë u pajtuan gojarisht që padiësi t'i japë të paditurit të parë një dyqan afarist me sipërfaqe rreth 120 m² në katin përdhes të një ndërtese që do të ndërtohej në të ardhmen në truallin që ai synonte ta blinte, si kompensim për punën e tij në bartjen e të drejtave pasurore të atij trualli dhe në marrjen e lejes komunale për ndërtim (fakti i provuar d). I padituri i parë arriti ta realizojë kalimin e pronësisë dhe në vitin 1987 toka u ble nga padiësi (faktet e provuara a) dhe d)). Gjithashtu rreth vitit 1988 u mor leja e ndërtimit nga i padituri i parë dhe objekti u ndërtua (fakti i provuar e). Pas ndërtimit, rreth viteve 1989-1990, i padituri i parë hyri në posedim të një pjese të ndërtesës në katin përdhes, me një sipërfaqe totale prej 114,05 m² (fakti i provuar i).

Bazuar në situatën e përshkruar faktike të vërtetuar, gjykata duhet të vendosë nëse me marrëveshje verbale i padituri i parë duhet konsideruar pronar i dyqaneve që ai posedon apo, në të kundërtën, nëse këto dyqane janë pronë e padiësit dhe janë okupuar në mënyrë të paligjshme.

Si rregull, përderisa nuk ndalohej, palët kishin të drejtën të lidhnin kontrata që u nënshtroheshin dispozitave të *LKD-së* (nenet 10 dhe 25 (1), (3) të *LKD-së*). Marrëveshja e përshkruar verbale mes palëve duhet të konsiderohet si kontratë paraprake (duke iu referuar nenit 45 (1) të *LKD-së*). Në fakt, ajo kishte për qëllim t'i prodhonte efektet e saj në të ardhmen, d.m.th.: nëse i padituri i parë do të përmbushte detyrimet e tij për bartjen e së drejtës pasurore dhe marrjen e lejes së ndërtimit dhe kur godina të ishte gati, atëherë padiësi do t'i jepte atij një dyqan me sipërfaqe 120 m² në katin përdhes. Bartja e pronësisë së dyqanit tek i padituri i parë do të duhej të përfundonte me një kontratë në të ardhmen, sepse në kohën e marrëveshjes

verbale dyqani nuk ekzistonte dhe prandaj çdo kontratë finale lidhur me bartjen e tij do të ishte e pavlefshme nga mungesa e objektit (nenet 46 (2) dhe 47 të LKD-së).

Në këndvështrimin e gjykatës, rregulli i zbatueshëm për interpretimin e kontratave sipas të cilit një kontratë me detyrime duhet të interpretohet në një mënyrë që krijon marrëdhënie të barabartë në mes të zotimeve të ndërsjella (Neni 101 i *LKD-së*), shpie në përfundimin se në marrëveshjen e tyre verbale palët morën përsipër detyrimet për të lidhur një kontratë kryesore në të ardhshmen; bartja e pronësisë së dyqanit tek i padituri i parë nuk u parapa si efekt i menjëhershëm i marrëveshjes dhe ajo do të duhej të ishte objekt i një kontrate të ardhshme të vlefshme për t'ia bartur të drejtën atij. Duke pasur parasysh këtë përfundim, gjykata konstaton se kontrata paraprake nuk i përmbushi kërkesat ligjore të formës. Kushtet lidhur me formën e kontratës kryesore ishin të zbatueshme për kontratën paraprake (neni 45 (2) i *LKD-së*) dhe meqenëse çështja ka të bëjë me bartjen e të drejtave pasurore mbi një pronë të paluajtshme, forma ligjore e detyrueshme ishte kontrata me shkrim e nënshkruar nga të dyja palët dhe e vërtetuar nga gjykata, përndryshe ajo do të ishte e pavlefshme (neni 4 § 2,3 i *LTPP-së*). Pra, jo vetëm sepse detyrimi formal është një kusht specifik vlefshmërie i kontratës paraprake, por edhe sepse çdo kontratë që nuk ishte lidhur në formën e përcaktuar, nuk do të kishte efekt ligjor (nenet 45 (2) dhe 70 (1) të *LKD-së*), marrëveshja verbale e përmendur nuk ishte e vlefshme as për të bartur pronësinë e dyqanit menjëherë tek i padituri i parë, as për ta ngarkuar paditësin me detyrimin për ta bartur atë në një kontratë përfundimtare.

Por ky përfundim nuk e mbyll diskutimin, sepse përveç kontratës ka edhe forma të tjera për të fituar të drejtat pasurore. I padituri i parë pretendoi nga ana tjetër se ai e fitoi të drejtën pasurore me “investime të përbashkëta”. A është kështu?

Krahas blerjes së të drejtave pasurore me kontratë – që gjykata sapo e konsideroi të pabazuar – dhe me trashëgimi – që nuk është e zbatueshme – i pranueshëm ishte edhe fitimi me ligj, përkatësisht duke ndërtuar në tokën e dikujt tjetri (nenet 20 § 1 dhe 21 të *LPDR-së*). Megjithatë, duke i parë me kujdes dispozitat e *LPDR-së*, gjykata konstaton se fitimi i të drejtave pasurore mbi tokën në të cilën u ndërtua objekti, pranohet vetëm për rastet kur ekzistojnë të drejta të ndryshme pronësore mbi tokën dhe objektin e ri, d.m.th., kur dikush ka ndërtuar një objekt në tokën që nuk është e tij, dhe kur kërkesa është për fitimin e të drejtave pasurore mbi tërë objektin dhe tokën (nenet 24, 25 dhe 26 të *LPDR-së*). Në këtë rast nuk është kështu. I padituri i parë mbuloi vetëm pjesërisht shpenzimet e ndërtimit bashkë me pronarin e tokës, i cili mbuloi pjesën tjetër të tyre. Ai nuk pretendon se është pronar i tërë objektit sepse nuk e ndërtoi i vetëm. Ajo që kërkon i padituri i parë është që të konsiderohet pronar i 114,63m² të objektit. Ky fitim i pjesshëm nuk mund të jepet në bazë të dispozitave të referuara të *LPDR-së*.

Sipas mendimit të gjykatës, i padituri i parë nuk i fitoi në mënyrë të vlefshme të drejtat pasurore mbi lokalet që ai i posedon dhe nuk mund të shpallet pronari i tyre. Ai mund të ketë të drejtën t'i paguhet investimi i tij, por kjo është pasojë ligjore krejtësisht e ndryshme, që do të trajtohet më tutje.

II.5.3 Okupimi dhe rikthimi i objektit nga të paditurit

Meqenëse gjykata arriti në përfundimin se i padituri i parë nuk mund të konsiderohet pronar i të drejtave pasurore mbi objektin dhe pasi që u vërtetua se ai hyri në posedim të dyqaneve me sipërfaqe prej 113,05 m² (fakt i provuar i), tani është momenti të verifikohet nëse ai i mban ato të okupuara në mënyrë legjitime apo abuzive.

Ndërtimi i pjesshëm i ndërtesës përfundoi rreth viteve 1989-1990 dhe i padituri i parë hyri menjëherë në posedim të një sipërfaqeje të barabartë me atë që vite më parë i ishte premtuar se do t'i jepej. Për më tepër, ai e bëri këtë pasi shpenzoi paratë e tij për finalizimin e ndërtimit sipas marrëveshjes me paditësin (faktet e provuara (c), dh), h) dhe i). Vetëm shtatë vjet më pas, paditësi reagoi duke paraqitur padi në gjykatë (duke iu referuar lëndës së zhdukur C. nr. 230/97). Nga këto fakte, është e mundur të nxirren dy konkluzione të padiskutueshme: në radhë të parë, i padituri i parë hyri në posedim të dyqanit i bindur se ai kishte të drejtë ta bënte këtë; në radhë të dytë, paditësi e autorizoi atë të vepronte kështu, ose të paktën nuk e kundërshtoi atë, duke forcuar bindjen e të paditurit të parë se ai po vepronte drejt. I padituri i parë veproi në mënyrë të arsyeshme, me bindjen se ai e kishte këtë të drejtë, dhe gjykata nuk mund të konkludojë se ai veproi gabim (në kuptim të nenit 158 të *LKD-së*). Prandaj, gjykata konstaton se ai nuk bëri shkelje të të drejtave pasurore të paditësit (në kundërshtim me Nenin 3 § 2 të *LPDR-së*) dhe se ai veproi si mbajtës i ndërgjegjshëm (për qëllimin e nenit 38 të *LPDR-së*). Vetëm tani me këtë aktgjykim, çështja e pronësisë është sqaruar dhe i padituri i parë është i vetëdijshëm se ai nuk mund t'i mbajë më dyqanet në posedim në mënyrë legjitime.

Lidhur me të paditurin e dytë, ai nuk është në posedim të dyqaneve në emër të tij, por në vend të kësaj, në emër të vëllait të tij, të paditurit të parë, i cili e autorizoi ta bëjë këtë (fakti i provuar i). Prandaj, *a fortiori* gjykata gjithashtu konsideron se ai nuk po shkel të drejtat e paditësit duke vepruar gabim.

Por konkluzionet e mësipërme nuk do të thonë se dyqanet në posedim të të paditurit të parë dhe të dytë nuk duhet t'i kthehen paditësit. Siç vuri në dukje gjykata, i padituri i parë nuk i fitoi të drejtat pasurore mbi objektin dhe nuk ka asnjë arsye tjetër ligjore që t'ia pranojë atij posedimin. Ai nuk është qiramarrës dhe nuk ka asnjë titull tjetër ligjor ose kontraktual për ta ruajtur okupimin. Paditësi është padyshim pronari i tokës dhe i ndërtesës dhe ka të drejtë t'i posedojë dhe t'i kthehen ato (nenet 3 § 1 dhe 37 të *LPDR-së*). Kjo e drejtë nuk përfundon me kalimin e kohës (Neni 37 § 3 i *LPDR-së*). Si pasojë, të paditurit duhet t'ia kthejnë dyqanet paditësit.

II.5.4 Kërkesa e paditësit për dëmshpërblim

Paditësi i kërkoi gjykatës të marrë një aktgjykim me të cilin t'i miratojë atij kompensim për dëmet e ndodhura nga privimi nga prona e tij. Si rregull, ligji pranon dëmshpërblim kur dikush e ka përdorur pronën e tij në mënyrë të paligjshme (Neni 219 i *LKD-së*). Por në këtë rast paditësi nuk e ka atë të drejtë për tre arsye të ndryshme, por njësoj të forta.

Në radhë të parë, e drejta për t'u kompensuar ka skaduar për shkak të kalimit të kohës. E drejta për të kërkuar dëmshpërblim për humbjet ka skaduar brenda tre viteve, duke filluar në momentin që paditësi u vu në dijeni për dëmin (Neni 376 (1) i *LKD-së*). Meqenëse i padituri i parë hyri në posedim të pronës në vitet 1989-1990, datë në të cilën paditësi u vu në dijeni për privimin nga prona, kërkesa për kompensim do të duhej të ishte paraqitur deri në fund të vitit 1993, të paktën. Meqenëse paditësi paraqiti padi për këtë çështje vetëm në vitin 1997 (duke iu referuar lëndës së zhdukur C. nr. 230/97), kërkesa është e vonuar. Gjykata mund ta shqyrtojë padinë e vonuar për shkak se të paditurit u bazuan tek ajo në fjalët e tyre përfundimtare (proces-verbali në faqen 141 dhe fjalët e shkruara në faqen 145).

Në radhë të dytë, kur hyri në posedim të dyqanit i padituri i parë veproi në mirëbesim dhe kjo do të thotë se ai duhet të konsiderohet si mbajtës i ndërgjegjshëm. Meqenëse është kështu, edhe sikur e drejta për dëmshpërblim të mos ishte parashkruar, ai nuk duhet të paguajë dëmshpërblim për shfrytëzimin e pronës (Neni 38 i *LPDR-së*).

Në radhë të tretë, në rast se do të konsiderohej se padia nuk ishte parashkruar dhe paditësi do ta kishte të drejtën të dëmshpërblehej, edhe po të ishte kështu, kjo e drejtë nuk mund të jepet për shkak të keqpërdorimit të saj. Ligji ka vendosur parimin e mirëbesimit dhe të ndershmërisë në krijimin e marrëdhënieve detyimore dhe realizimin e të drejtave dhe detyrimeve përkatëse, dhe ndalon realizimin e një të drejte në kundërshtim me qëllimin e vendosur ose të njohur nga ligji në lidhje me të drejtën e tillë (nenet 12 dhe 13 të *LKD-së*). Kjo do të thotë se një e drejtë formalisht ekzistente nuk mund të ushtrohet në një mënyrë që do të çonte në një pasojë madhore të padrejtë si rezultat i një sjelljeje në kundërshtim me mirëbesimin dhe ndershmërinë. Kështu ndodh normalisht kur dikush ka për qëllim të përfitojë nga një situatë që ai e ka krijuar kundër interesave të të tjerëve – *venire contra factum proprium non potest*. Paditësi premtoi t'i jepte të paditurit të parë një dyqan, në qoftë se ai e ndihmonte atë, siç bëri, i kërkoi të paguante mbarimin e ndërtimit, siç bëri ai, dhe pranoi për disa vite që ai ta posedonte dyqanin, siç dhe bëri; por pastaj, pasi krijoi bindjen se i padituri i parë po vepronte drejt dhe në përputhje me marrëveshjen e tyre, pretendon të kompensohet për dëmet që ai vetë i krijoi. Ky është keqpërdorim i ndaluar i një të drejte formale, kundër parimeve të mirëbesimit dhe të ndershmërisë, prandaj nuk mund të miratohet nga gjykata.

II.5.5 Kërkesa e të paditurit për dëmshpërblim

I padituri i parë paraqiti kundërpadi ndaj paditësit, ku kërkoi të kompensohej për dëmet në shumën €3.731,78, që përputhet me investimet që ai bëri në pronë.

U provua se vlera e përgjithshme e ndërtimit të objektit është €70.311,48, në të cilin i padituri i parë shpenzoi €28.105,37 dhe paditësi €16.569,70 (faktet e provuara g) dhe h) – shuma e përgjithshme e këtyre shumave është €44.675,07. Palët nuk paraqitën prova të mjaftueshme për pagimin e shumës së mbetur €25.636,41. Investimi i paditësit dhe të paditurit të parë përfaqëson përkatësisht 37,08 % dhe 62,90 % të shumës së ditur. Atëherë, duke zbatuar

përqindjen e njëjtë në lidhje me shumën që nuk dihet, është e mundur të vlerësojmë se paditësi shpenzoi më shumë €9.505,98 dhe i padituri i parë më shumë se €16.125,30. Është përfundim i arsyeshëm dhe i drejtë po të supozojmë se i padituri i parë investoi për ndërtimin vlerën totale prej €44.230,67, ndërsa paditësi €26.075,68.

I padituri i parë, sipas marrëveshjes me paditësin, përfundoi ndërtimin e objektit duke investuar shumën e përmendur të parave të tij (fakti i provuar f). Kjo marrëveshje nuk mund të konsiderohet kontratë për furnizimin e shërbimeve (neni 600 i *LKD-së*) ose kontratë ndërtimi (Neni 630 i *LKD-së*). Në të dyja këto kontrata, personi që përfiton nga shërbimet ose nga ndërtimi merr përsipër detyrimin e pagimit të shpërblimit monetar dhe në këtë rast nuk kishte ndonjë marrëveshje të tillë. I padituri i parë përfundoi ndërtimin për të mos u paguar, por paraprakisht me bindjen se ai do të ishte pronar i një pjese të objektit. Prandaj e drejta për t'iu kthyer investimi i tij, nuk mund të analizohet në këndvështrimin e një detyrimi kontraktual.

Gjykata konstaton se kjo situatë bie nën dispozitat e përgjithshme të detyrimit dhe përgjegjësisë civile dhe nën dispozitat e posaçme mbi rikthimin e shpenzimeve të bëra për një person tjetër. Çdo zgjidhje tjetër që do të shpinte në një rezultat sipas të cilit paditësi do të merrte pronësinë e tërë ndërtesës, pa i paguar të paditurit të parë investimet e tij, do të shpinte në një pasurim të padrejtë e të papranueshëm.

Sjellja e paditësit duke rënë dakord me të paditurin e parë që ai të shpenzonte para për një ndërtim, me hamendjen se ai do të merrte në pronësi një pjesë të saj, por pastaj refuzimi për t'ia bartur atij këtë të drejtë, përbën shkak dëmtimi të qëllimshëm dhe e detyron atë të paguajë dëmshpërblim, përveç nëse ai provon se nuk kishte asnjë faj, gjë që nuk e bëri (nenet 154 dhe 158 të *LKD-së*). Nga ana tjetër, ligji gjithashtu deklaron se kushdo që paguan për shpenzimet për një person tjetër, të cilat ishin detyrë e personit të tillë, ka të drejtë të kërkojë kthimin e këtyre shpenzimeve prej personit të tillë (Neni 218 i *LKD-së*). Bazuar në dispozitat e përmendura, gjykata gjen se paditësi duhet ta kompensojë të paditurin e parë për të gjitha investimet e tij për ndërtimin. Kompensimi do të jetë i barabartë me paratë që ai shpenzoi – €44.230,63 – si pasojë e parimit të rivendosjes së gjendjes para dëmit (nenet 185 (1) dhe 190 të *LKD-së*).

II.6 PËRFUNDIME

I padituri i dytë ka legjitimitet pasiv.

I padituri i parë nuk i fitoi në mënyrë të vlefshme të drejtat pronësore mbi lokalin që ai po posedon dhe nuk mund të shpallet pronar i tij. Prandaj kërkesa e paditësit për kthimin nga ana e të dy të paditurve pranohet dhe kërkesa e të paditurit të parë për t'u njohur si pronar nuk pranohet.

Kërkesës së paditësit për kompensim monetar i ka kaluar afati. Edhe sikur të mos i kishte kaluar ky afat, ai nuk ta kishte të drejtën për t'u kompensuar, sepse okupimi nga paditësi i parë ishte në mirëbesim dhe paditësi po keqpërdorte të drejtën e tij dhe po e ushtronte atë në mënyrë abuzive.

I padituri i parë ka të drejtën të kompensohet nga paditësi për investimin e tij në ndërtimin e objektit, dhe prandaj ai ka të drejtë të marrë nga paditësi €44.230,67.

II.7 SHPENZIMET PËR PROCEDURËN

Sipas rregullave të nenit 452 të LPP-së, duke marrë parasysh se të dyja palët ishin pjesërisht të suksesshme në paditë e tyre dhe se nuk është e mundur që kjo të përcaktohet në aspektin sasior, gjykata e konsideron të drejtë që secili prej tyre paguajë shpenzimet e veta.

III. MJET LIGJOR

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit, sipas neneve 176, 178 dhe 185 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS, DEGA NË KLINË

C. nr. 222/2007, më 24 tetor 2013

Gjyqtari i EULEX-it Manuel Soares